



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*  
*Departamenti i Buxhetit / Departamentat Budzeta / Budget Department*

**Takimi i Komisionit të Granteve**

(datë: 04 Prill 2017, e martë, 15:00-16:00)

**Procesverbali i takimit:**

Me datë 04 Prill 2017, në sallën e takimeve kati 11 në Ministrinë e Financave, u zhvillua takimi i Komisionit të Granteve ku sipas agjendës u diskutua “Shqyrtimi dhe aprovimi i Granteve Qeveritare për financimin e komunave për vitin 2018 në kontest të finalizimit të KASH 2018-2020 përfshirë kriteret dhe ndarjen e granteve sipas LFPL. Këtë takim e kryesoi Ministri i Financave z. Avdullah Hoti.

**Pjesëmarrësit:**

Z. Avdullah Hoti, Ministër i Financave, Agim Krasniqi, zv. Ministër në Ministrinë e Financave, z. Valentin Toçi, Këshilltar i Kryeministrit të Kosovës, z. Bajram Gecaj, zv. Ministër i MAPL, z. Mevludin Krasniqi, Zv. Ministër i MASHT, z. Imet Rrahmani, Ministër i Shëndetësisë, z. Safet Kamberi, zv. Ministër i MPMS, z. Muharem Sfarça, Kryetar i Komunës Ferizaj, z. Stevan Vulović, Kryetar i Komunës Zubin Potok, z. Lulzim Sylejmani, Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunës Rahovec, Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL, Alush Istogu, Sekretar i Përgjithshëm në MASHT, Mentor Morina, Udhëheqës në MPMS, Jeton Gashi/Kimete Zekaj/Jeton Kryeziu/Hyrisha Islami/Doruntina Grejçevci, anëtarë të Sekretarisë së Komisionit të Granteve në MF, Mevlide Shamolli dhe Nazmije Fazliu, Departamenti i Buxhetit në MF.

**Agjenda - qëllimi i takimit:**

- Aprovimi i draft Procesverbalit nga takimi i Komisionit të Granteve, datë 03 Shkurt 2017;
- Roli dhe përgjegjësitë e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve, të përcaktuar me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal;
- Shqyrtimi i dokumentit udhëzues me tabelat e propozim granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2018 duke përcaktuar kriteret dhe formulat me parametrat bazë si dhe të marrë vendime për burimet e financimit sipas komunave për vitin 2018 dhe parashikimet 2019-2020, si pjesë integrale e KASH-it 2018-2020.
- Tjetër.

Z. Avdullah Hoti, Ministër në MF i përshëndeti të pranishmit me mirëseardhje si dhe i informoi anëtarët e Komisionit të Granteve për rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve, të përcaktuar me nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal dhe për parimet bazë të dokumentit udhëzues për anëtarët e Komisionit të Granteve për vitin 2017 mbi ndarjen e granteve qeveritare për financimin komunal 2018-2020.

Më tutje Ministri theksoi se parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2018 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit lokal (LFPL). Sa i përket Grantit të Përgjithshëm për vitin 2018 Ministri theksoi se ky grant është në shumë prej 173,600,000 euro që krahasuar me vitin 2017 ka pësuar rritje prej 16% nga viti paraprak. Pjesa prej 2.7 % e grantit të përgjithshëm shpërndahet për 14 komunat që kanë numër të popullsisë nën 22,000 banorë. Sa i përket financimit të shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Gjithashtu të punësuarit në administratën e drejtorive komunale për arsim parauniversitar dhe shëndetësi financohen nga granti i përgjithshëm në komuna.

Sa i përket grantit specifik për arsim sipas LFPL, Ministri theksoi se kjo ndarje bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2018.

Gjatë analizës së propozim grantit specifik për arsim të dorëzuar nga MASHT kemi vërejtur se ka zvogëlim të numrit të nxënësve për 8,600 më pak në arsimin parauniversitar që në llogaritjen e grantit për arsim kjo rënie në numrin e nxënësve nënkupton rreth 430 norma më pak, ku të gjitha këto norma do të mbahen në arsim në cilësinë e koordinatorëve të cilësisë në shkolla. Gjithashtu granti për arsim për vitin 2018 është në shumë prej 170,270,451 euro ose me një rritje prej 4.5 % nga viti paraprak për shërbime me efikase në nivel të shkollave.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2018 është në shumë prej 48,523,950 euro dhe me një rritje prej 10 % nga viti paraprak për kryerjen e shërbimeve sa me efikase. Shpërndarja e grantit specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2018 është përgatitur në harmoni me prioritet e qeverisë si dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal për vitin 2016.

Sa i përket financimit për shëndetësi sekondare për vitin 2018 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 2,603,077 euro sipas prioriteve të qeverisë, projeksionet në KASH dhe propozimit nga MSH.

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit sipas MPMS për vitin 2018 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 1,650,000 euro dhe financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore të fshatit Zym dhe Këshillin e Hoçës së madhe për vitin 2018 në shumë prej 63,093 euro për zbatimin e ligjeve në fuqi.

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2018 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 82 milion euro apo me një rritje prej 3% krahasuar me vitin paraprak.

Sa i përket Fondeve të ndara nga Huamarrja në MASHT për vitin 2018 janë aprovuar në shumë prej 790,440 euro, dhe për vitin 2019 në shumë prej 461,090 euro, ndërsa fondet e ndara nga Huamarrja prej 8.5 milionë euro, në kuadër të MSH-së transferohen në komuna për vitin 2018 në shumë prej 2.9 milionë euro dhe për vitin 2019 në shumë prej 5.3 milionë euro.

Z. Lulzim Sylejmani përfaqësues nga komuna e Rahovecit theksoi se projeksionet e të hyrave për vitin 2018 për komunën e Rahovecit janë të larta dhe është një planifikim i paarritshëm.

Z. Imet Rrahmani, Ministër i shëndetësisë, theksoi se huamarrja le të mbetet si total në komuna, ndërsa shpërndarja të bëhet me qarkore buxhetore.

Z. Stevan Vuloviç, Kryetar i komunës së Zubin Potokut, kërkoi që të mos mirret për bazë regjistrimi aktual i popullsisë sepse sipas tij komunat po dëmtohet në ndarje të granteve.

Z. Alush Istogu nga MASHT, theksoi se këto tabela të këtij dokumenti janë të nevojshme të përfshihen edhe në qarkoret buxhetore për informata me të detajuara sa ai përket shpërndarjes së normave sipas komunave (në veçanti për informimin e MAP-it).

Ministri z.Hoti përkrahi mendimet e anëtarëve të komisionit të granteve dhe theksoj se në të ardhmen do të mirren parasysh kërkesat e tyre.

**Anëtarët e Komisionit të Granteve me të gjitha votat aprovuan pakon e materialit të prezantuar me shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2018 në shumë prej 482,401,012 euro, si vijon:**

- Granti i Përgjithshëm për vitin 2018 në shumë prej 173,600.000 euro;
- Granti Specifik i Arsimit për vitin 2018 në shumë prej 170,270,451 euro;
- Granti Specifik i Shëndetësisë për vitin 2018 në shumë prej 48,523,950 euro;
- Financimi për Shëndetësi Sekondare për vitin 2018 në shumë prej 2,603,077 euro;
- Financimi i Shërbimeve Rezidenciale për vitin 2018 në shumë prej 1,650,000 euro;
- Financimi për Qendrën historike të Prizrenit, Qendrën kulturore të fshatit Zym dhe Këshillin e Hoçës së madhe për vitin 2018 në shumë prej 63,093 euro;
- Të hyrat Vetanake për vitin 2018 në shumë prej 82,000,000 euro; dhe
- Financimi nga Huamarrja për vitin 2018 në shumë prej 3,690,440 euro nga kjo shuma 790,440 euro për arsimin parauniversitar dhe 2,900,000 euro për shëndetësi primare.

**Vërejtje:** Ky draft procesverbal do të aprovohet në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të Granteve.